



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 72/2 Prot

Tiranë, më 20 . 03 .2024

VENDIM

Nr. 05 , datë 20 . 03 .2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Emisioni “Piranjat”, përfaqësuar nga z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2349 Prot., datë 20.12.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë/ Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion nëpërmjet shërbimit postar me datë 05.12.2023, duke kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

- *Strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe listën emërore të punonjësve sipas pozicionit përkatës.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, Komisioneri vlerësoi se, ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 2349/1 prot., datë 22.12.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 29.12.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 241075/5 Prot., datë 29.12.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 2349/2 Prot., datë 03.01.2024, ka sqaruar ndër të tjera se: *“...Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore është trajtuar kërkesa sipas kthim përgjigjes me nr. 241075/3 Prot., datë 20.12.2023 me anë të së cilës ju është bërë me dije se: Në zbatim të LDI si dhe në përputhje me programin e transparencës, të dhënat mbi strukturën organizative janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit www.dpttv.gov.al. Sa më sipër sqarojmë se, Autoriteti jonë ka zbatuar legjislacionin në fuqi, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 15 të LDI, pasi emisioni “Piranjat” ka marrë përgjigje për kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar në këtë nen.”*

Me emailin e regjistruar me nr. 72/1 Prot., datë 01.02.2024, ankuesi ka vijuar ankimin duke sqaruar se: *“...Informacioni i vënë në dispozicion nuk është i plotë, pasi në kërkesën për informacion është kërkuar jo vetëm struktura, por edhe lista emërore e punonjësve me pozicionin përkatës pranë Autoritetit Publik”*.

Në vijim, Komisioneri me emailin datë 02.02.2024, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion sipas objektit të saj, brenda datës 05.02.2024.

Me emailin e datës 05.02.2024 Autoriteti Publik ka bërë me dije Komisionerin se, *Titullari i institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore është ndryshuar dhe institucioni ndodhet në proces ristrukturimi dhe ndodhur në këto kushte kërkojmë mirëkuptimin tuaj. Gjithashtu, me emailin e datës 22.02.2024 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje për ankuesin duke mbajtur të njëjtin qëndrim.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo çështje duhet të trajtohet me LDI, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Kërkesa për informacion e paraqitur nga ankuesi bazohet në LDI dhe konsiston në marrjen e informacionit mbi emrat dhe pozicionin përkatës të punonjësve pranë

Autoritetit Publik. Rrjedhimisht, duke qenë se kërkohen të dhëna që lidhen me ushtrimin e detyrës funksionale të punonjësve në një autoritet publik, gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se *“Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”*.

Gjithashtu, bazuar në shkronjën d), të pikës 1, të nenit 7, të LDI dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”*.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur një pjesë e informacionit të kërkuar rezulton publik në mënyrë proaktive në programin e tij institucional të transparencës.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Komisioneri, megjithëse ka mirëkuptuar vështirësitë e hasura për shkak të procesit të ristrukturimit, për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, nuk përjashton në asnjë moment Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën. Për më tepër, lidhur me të njëjtin objekt kërkimi për raste të tjera, Komisioneri ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 2349 Prot., datë 20.12.2023, të Emisionit “Piranjat”, përfaqësuar nga z. [Emri i personit], kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 05.12.2023, konkretisht: “Listën emërore të punonjësve sipas pozicionit përkatës”, brenda datës 28 . 03 .2024.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 20 . 03 .2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi